



16-22 MARS

JAVA E MBROJTJES



REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI NUFI, VIZITË NË FORCËN TOKËSORE

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, zhvilloi vizitën e tij të parë, pas marrjes së detyrës, në Komandën e Forcës Tokësore në Zall-Herr. Në takimet me gjeneralë, efektivë dhe drejtues të forcës u prezantuan objektivat kryesore dhe funksionimi i strukturave të Forcës Tokësore. Gjatë vizitës u theksua angazhimi për forcimin dhe modernizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura.





KOMPENSIM PËR EFEKTIVËT E EMËRUAR JASHTË VENDBANIMIT

Këshilli i Ministrave miratoi një vendim për “Përcaktimin e kriterëve dhe të masës së kompensimit të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur emërohet ose komandohet në detyrë jashtë vendbanimit të tij”. Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi tha se vendimi synon përmirësimin e trajtimit financiar. Kostoja do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



MINISTRI I MBROJTJES TAKIM ME ATASHETË

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, zhvilloi një takim prezantues me Atashetë Ushtarakë të akredituar në Shqipëri, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e sigurisë. Ai nënvizoi se bashkëpunimi ndërkombëtar mbetet themeli i sigurisë së përbashkët dhe se Shqipëria vijon të luajë një rol aktiv në kuadër të partneriteteve strategjike.





STËRVITJA SHUMËKOMBËSHE “INIOCHOS 2026”

Forca Ajrore mori pjesë në stërvitjen shumëkombëshe “INIOCHOS 2026”, të zhvilluar në Bazën Ajrore Andravida, nën drejtimin e Forcës Ajrore greke. FASh u përfaqësua me një helikopter Cougar, një Land Rover dhe 11 efektivë. Ekuipazhi realizoi 5 misione transporti dhe 2 rikonjicioni, në bashkëpunim me forcat polake, sipas standardeve të NATO.





PËRFUNDON KURSI “JCLC”

Në Shkollën e Trupës së Forcës Tokësore përfundoi kursi “Junior Command and Leadership Course (JCLC)”, pas katër javësh trajnim intensiv. Në të morën pjesë 33 kursantë të këmbësorisë nga strukturat e Forcave të Armatosura, të cilët përfituan njohuri në lidhësi me lidhësi, drejtim dhe vendimmarrje në nivel taktik. Trajnimi u realizua nga instruktorët vendas në bashkëpunim me ekipin britanik BMATT.

